

AKTI I THEMELIT DHE STATUTI

I

SHOQËRISË “PORTA E ALPEVE” SH.P.K.

Në mbështetje të ligjit nr . 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, i ndryshuar, që rregullojnë marrëdhëniet tregtare dhe funksionimin e shoqërive;

Shoqëria “Evision” shpk, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, pajisur me Nipt M31603002U, me seli në Tiranë në Rr:”Thoma Filipeu”, Zk.2460, nr.pasurie 496/129, vol, 8, fq. 217, përfaqësuar nga administratori **Z. Martjan Dedi**, lindur më 23.07.1985 në Gjirokastër dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal I50723085P me cilësinë e Ortakut themelues;

Z. Ylli Sterkaj, lindur më 20.04.1969 në Dedaj, Shkodër, dhe banues në Malësi e Madhe, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal G90420080W me cilësinë e Ortakut themelues;

Z. Mati Pepa, lindur më 25.05.1963 në Shkodër dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal G30525257W me cilësinë e Ortakut themelues;

Z. Indrit Banka, lindur më 02.01.1974 në Tiranë dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal H40102108C me cilësinë e Ortakut themelues;

Hartojnë këtë akt themelimi dhe statut të Shoqërisë Tregtare “**PORTA E ALPEVE**” SH.P.K.

KAPITULLI I

Data e Themelimit, Emri, Forma, Selia, Kohëzgjatja

Neni 1

Data e Themelimit dhe Emri

- 1.1 Sot më datë 05.05.2025 themelohet shoqëria “**PORTA E ALPEVE**” (në vijim “Shoqëria”), e ndjekur në mënyrë të pandashme nga shkurtimi “Sh.p.k.”, që përfaqëson formën ligjore të saj, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.
- 1.2 Ortakët e Shoqërisë (në vijim “Ortakët”) janë përgjegjës të kufizuar deri në limitin e kontributit përkatës në kapitalin e shoqërisë të përfaqësuar në kuota.
- 1.3 Në të gjitha dokumentet, faturat, njoftimet të lëshuara nga Shoqëria, pavarësisht nga mënyra e dërgimit, emri i saj do të ndiqet ose do të shoqërohet nga:

- a. shprehja “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar” ose “Sh.P.K.”;
- b. numri i Identifikimit Personal Tatimor (NIPT) të saj;
- c. adresa e regjistruar;
- d. pasqyrimi i faktit që shoqëria është në procedurë likuidimi, në rast se shoqëria është në likuidim;

Neni 2

Forma dhe Baza Ligjore

- 2.2 Shoqëria është një entitet ligjor shqiptar, dhe ka formën ligjore të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (në vijim “sh.p.k.”), në përputhje me ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar (në vijim “Ligji i Shoqërive”).

Neni 3

Selia

- 3.1 Selia e shoqërisë do të jetë në adresën **Lohej e Poshtme, Malësi e Madhe, Shkodër**.
- 3.2 Shoqëria mund të krijojë filiale, zyra përfaqësimi e agjensi në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit.

Neni 4

Kohëzgjatja

- 4.1 Veprimtaria e Shoqërisë fillon pas regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar.
- 4.2 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë “PORTA E ALPEVE” SH.P.K. është **pa afat**. Ortakët kanë të drejtë të kufizojnë këtë afat duke zbatuar procedurat për ndryshimin e Statutit.

KAPITULLI II

Neni 5

Objekti i Shoqërisë

- 5.1 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë në përputhje me legjislacionin shqiptar do të jetë:
 - *Import, eksport, tregtim dhe furnizim me shumicë e pakicë të energjisë elektrike. Ndërtim, zhvillim, dhe menaxhim i impjanteve, sistemeve të prodhimit, shpërndarjes, transmetimit të energjisë elektrike. Shitje, blerje, dhënie me qera të pasurive të paluajtshme. Ofrim i shërbimit të konsulencës, projektim inxhinjrik dhe asistencë teknike. Veprimtaria e agroturizmit, serave hidroponike, veprimtarinë e ndërtimtarisë, shërbimin spitalor, azile për të moshuarit dhe veprimtari që lidhen me to, menaxhim i shtëpive për të moshuar. Veprimtari prodhuese në fushën e industrisë së lehtë dhe ushqimore. Magazinim, grumbullim dhe përpunim i*

produkteve bujqësore të tjera të kësaj natyre. Çdo veprimatri tjetër që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për realizimin e qëllimit të shoqërisë dhe nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptarë në fuqi.

Neni 6

Ndryshime

- 6.1 Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj në çdo kohë, siç parashikohet në këtë Statut, duke marrë parasysh dispozitat Ligjore të Ligjit të Shoqërive.
- 6.2 Objekti i shoqërisë mund të ndryshohet dhe / ose shtohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.
- 6.3 Shoqëria mund të ushtrojë veprimtari të tjera plotësuese që janë të dobishme ose të nevojshme për realizimin e objektit të saj, në përputhje me ligjin shqiptar.
- 6.4 Shoqëria do të bashkëpunojë me persona të tjerë fizikë ose juridike që ushtrojnë të njëjtën veprimtari në Shqipëri ose jashtë saj, po ashtu edhe me shoqëri dhe persona që e ndihmojnë në realizimin e objektit të veprimtarisë së saj.

KAPITULLI III

Kapitali Themeltar, Kuotat e Kapitalit Themeltar

Neni 7

Kapitali Themeltar

- 7.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është përcaktuar në shumën 100,000 (njëqind mijë) lekë. Kapitali themeltar është i ndarë në 4 kuota.

Neni 8

Ortakët e Shoqërisë dhe Kuotat

- 8.1 Ortakët e Shoqërisë dhe kuotat e zotëruara prej tyre në Shoqëri janë si më poshtë:

➤ **Shoqëria “EVISION” shpk - 1 KUOTË ME VLERË 46.000 LEKË
OSE E SHPREHUR NË PËRQINDJE:**

Shoqëria “EVISION” shpk - 46 %

➤ **Z. Ylli Sterkaj, - 1 KUOTË ME VLERË 44.000 LEKË
OSE E SHPREHUR NË PËRQINDJE:**

Z.Ylli Sterkaj - 44 %

➤ **Z. Mati Pepa, - 1 KUOTË ME VLERË 5.000 LEKË
OSE E SHPREHUR NË PËRQINDJE:**

Z.Mati Pepa - 5 %

➤ **Z. Indrit Banka, - 1 KUOTË ME VLERË 5.000 LEKË
OSE E SHPREHUR NË PËRQINDJE:**

Z.Indrit Banka – 5%

Neni 9

Zvogëlimi ose Zmadhimi i Kapitalit Themeltar

- 9.1 Kapitali mund të zmadhohet ose zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, në përputhje me përcaktimet e këtij Statuti, dhe kërkesave të detyrueshme të Ligjit të Shoqërive.
- 9.2 Zmadhimi i kapitalit mund të realizohet me anë të kontributeve në para, me anë të kontributeve në natyrë ose me përfshirjen e rezervave (nëse ka) dhe fitimit.
- 9.3 Rritja e kapitalit do të bëhet me kuota të reja apo me rritjen e vlerës së kuotave ekzistuese. Pjesët e reja të kapitalit themeltar do të nënshkruhen dhe vlera e tyre nominale do të paguhet plotësisht.
- 9.4 Zmadhimi i kapitalit nuk do të rrisë përqindjet e pjesëmarrjes të Ortakëve në Kapitalin e Shoqërisë, përveç se kur vendoset ndryshe nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, vendim i cili do të merret me një shumicë prej $\frac{3}{4}$ e votave.
- 9.5 Shoqëria nuk mund të blejë asnjë kuotë të saj. Megjithatë, me qëllim zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, nëpërmjet vendimit për zvogëlimin e kapitalit, Ortakët mund të autorizojnë Administratorin të bëjë blerjen e kuotave përkatëse apo pjesë të tyre dhe t'i anulojë ato.

Neni 10

Të drejtat dhe detyrimet e Ortakëve

- 10.1 Ortakët janë vetëm ata të cilët zotërojnë kuotat e Shoqërisë.
- 10.2 Çdo Ortak do të ketë të drejta vote në Asamblenë e Përgjithshme të Ortakëve (në vijim "Asambleja e Përgjithshme") në përpjestim me vlerën nominale të kuotës që zotëron. Çdo Ortak ka të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në organet drejtuese, të drejtën për të marrë pjesë në shpërndarjen e fitimeve të Shoqërisë, nëse Asambleja e Përgjithshme vendos të shpërndajë fitimet, sikundër të drejtat e parashikuara nga ky Statut, për çdo marrëveshje të detyrueshme ndërmjet Ortakëve dhe dispozitave ligjore të Ligjit të Shoqërive.
- 10.3 Ortakëve do t'u jepen, me kërkesë me shkrim, informacione dhe të dhëna në lidhje me aktivitetin e Shoqërisë në çdo kohë, duke përfshirë të drejtën që të kontrollojnë dokumentat dhe raportet e Shoqërisë.

- 10.5 Detyrimet e Shoqërisë janë të garantuara nga kapitali i saj, dhe Ortakët mundet vetëm të mbajnë përgjegjësi brenda limitit të vlerës së kuotave që ata zotërojnë. Ortakët nuk mbajnë përgjegjësi që tejkalojnë investimin e tyre përkatësisht në kapitalin e Shoqërisë (përveç garancive dhe huave që ata realizojnë).

Neni 11

Transferimi i pjesëve të Kapitalit

- 11.1 Çdo transferim i kuotave apo pjesëve të tyre do të bëhet në përputhje me dispozitat e Ligjit të Shoqërive, dhe e statutit nëse parashikohet ndryshe si dhe duhet të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

KREU IV

Asambleja e Përgjithshme

Neni 12

Kompetencat

- 12.1 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi drejtues i Shoqërisë i cili merr vendimet mbi aktivitetin dhe politikat e saj ekonomike dhe tregtare.

Neni 13

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

- 13.1 Asambleja e Përgjithshme duhet të mbledhet të paktën 1 herë në vit.
- 13.2 Asambleja e Përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare rezulton ose ekziston rreziku që aktivitetet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- 13.3 Asambleja e Përgjithshme thirret kur Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, asete të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% të gjithë aseteve të Shoqërisë, siç rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara. Asambleja e Përgjithshme do të vendosë mbi bazën e raportit të ekspertit kontabël të autorizuar, që do t'i paraqitet Asamblesë, përveç rastit kur kjo blerje bëhet në Bursë ose bën pjesë në veprimtarinë e zakonshme tregtare të Shoqërisë.
- 13.4 Asambleja e Përgjithshme thirret kur Shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj propozon të blejë nga një Ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5% e aseteve të Shoqërisë, siç rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- 13.5 Në rastet e parashikuara në pikat e mësipërme 13.3 dhe 13.4, Asamblesë së Përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur, përveç rastit kur kjo blerje bëhet në Bursë ose bën pjesë në veprimtarinë e zakonshme tregtare të Shoqërisë.

- 13.6 Ortakët do të organizojnë takime me Administratorin të paktën një herë në vit me qëllim vlerësimin e veprimeve të kryera nga Administratori, diskutimin e çështjeve që kanë të bëjnë me administrimin e Shoqërisë dhe marrjen e vendimeve mbi çështjet që janë objekt i aprovimit nga ana e tyre, përfshirë çështje për të cilat Administratori nuk bie dakord.
- 13.7 Në rastet e parashikuara në pikat e mësipërme 13.3 dhe 13.6 Asambleja e Përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorit.

Neni 14

Mënyra e Thirrjes së Mbledhjeve

- 14.1 Asambleja e Përgjithshme thirret të vendosë për çështjet e shtruaara përpara saj nëpërmjet thirrjes së mbledhjeve ose nëpërmjet konsultave me shkrim.
- 14.2 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga Administratori ose nga çdo njëri prej Ortakëve.
- 14.3 Asambleja e Përgjithshme përgjithsisht mblidhet në selinë e Shoqërisë. Në çdo rast vendi i zgjedhur, data dhe ora e këtyre takimeve si dhe rendi i ditës përkatës i mbledhjeve u njoftohet Ortakëve me postë të regjitruar të paktën 7 ditë para mbledhjes. Në rast se Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur në përputhje me kërkesat e këtij paragrafi, kjo e fundit mund të marrë vendime të vlefshme vetëm në rast se të gjithë Ortakët bien dakort.

Neni 15

Kuorumi dhe marrja e vendimeve



- 15.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të Ligjit të Shoqërive, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij Ligjit.
- 15.2 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.
- 15.3 Secili prej Ortakëve gëzon të drejtën të përfaqësohet nga një person tjetër në përputhje me nenin 85 të Ligjit të Shoqërive.

- 15.4 Ortakët pranojnë dhe bien dakord me të drejtën për të marrë vendime në lidhje me Shoqërinë në formë të shkruar. Vendimi i propozuar së bashku me dokumentacionin mbështetës do t'u dërgohet Ortakëve me postë, korrier, email ose mënyra të tjera elektronike të sigurta. Ortakët do të marrin vendimin përkatës brenda një periudhe prej 15 ditësh nga dita që ju është dorëzuar rezoluta. Ortakët miratojnë vendimin duke i kthyer Administratorit të Shoqërisë një kopje të firmosur të vendimit me shkrim. Ortakët të cilët nuk janë dakord me vendimin shprehin me shkrim kundërshtitë e tyre në lidhje me vendimin dhe ja kthejnë atë Administratorit të Shoqërisë. Vendimi me shkrim konsiderohet i miratuar nëse aprovohet me shumicë të thjeshtë të votave të ortakëve pjesëmarrës.
- 15.5 Secili prej Ortakëve ka të drejtën të votojë në përputhje me kuotën e zotëruar prej tij në kapital.
- 15.6 Vendimet e mëposhtme do të miratohen me miratimin e Ortakëve që zotërojnë të paktën 75% të kapitalit të Shoqërisë:
- a. Pagesa e çdo dividendi në kesh apo natyrë e Ortakëve të Shoqërisë;
 - b. Nënshkrimi i marrëveshjeve financiare në lidhje me Shoqërinë apo nxjerrja e instrumentave të borxhit nga Shoqëria;
 - c. Blerja e çfarëdolloj kuote apo interesi tjetër në çdo biznes dhe sipërmarrje;
 - d. Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë siç është përcaktuar në këtë statut;
 - dh. Ndryshime dhe amendime të këtij Akti Themelimi;
 - e. Likuidimi apo shpërndarja e Shoqërisë.
- 15.7 Atëherë kur ligji e kërkon këtë, vendimet e Ortakëve duhet të noterizohen nga një noter publik Shqiptar.
- 15.8 Ortakët do të njoftohen për Asamblenë e Përgjithshme të Ortakëve dhe përmbajtjen e axhendës së takimit.
- 15.9 Administratori duhet të mbajë procesverbalet e çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, në përputhje me kërkesat e Ligjit të Shoqërive.

Neni 16

Përfashtimi nga e drejta e votës

- 16.1 Një ortak përfashtohet nga e drejta e votës në rastin kur Asambleja e Përgjithshme është duke vendosur mbi:
- a. Vlerësimin e veprimtarisë së këtij Ortaku;
 - b. Shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;



- c. Ngritjen e një padie kundër tij, nga Shoqëria;
 - d. Dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
- 16.2 Kur ky Ortak është i përfaqësuar nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi sikundër Ortaku të cilin përfaqëson.

KREU V

Administratori

Neni 17

Administratori dhe kompetencat

Administratori

- 17.1 Ortakët e shoqërisë, bien dakord që Administrator i shoqërisë **“PORTA E ALPEVE” SH.P.K.** të caktohet :
- **Z.Martjan Dedi**, lindur më 23.07.1985 në Gjirokastrë dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal I50723085P.
- 17.2 Afati i këtij mandati fillon me regjistrimin e këtij Statuti në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe vazhdon për **3 vjet** me të drejtë rizgjedhje.
- 17.3 Menjëherë pas pranimit të emërimit të tyre, Administratori njeh se marrëdhënia e tij me Shoqërinë ndërtohet mbi baza mirëbësimi. Lidhur me këtë vendimi për heqjen e tij nëpërmjet një vendimi të Asamblesë së Ortakëve gjykohet si arsye e ligjshme për shkarkimin e tij në përputhje me ligjet përkatëse.
- 17.4 Ortakët kanë të drejtën të shkarkojnë Administratorin me shumicë të thjeshtë votash.
- 17.5 Administratori duhet të informojë Ortakët për çdo veprim dhe të marrë paraprakisht miratimin e tyre për çdo veprim që ndërmerret në cilësinë e administratorit.
- 17.6 Për aq sa është e lejueshme dhe në përputhje me legjislacionin Shqiptar ose me çdo legjislacion ku aktet e Administratorit kanë fuqi vepruese.

Neni 18

Kompetencat dhe detyrimet

- 18.1 Administratori drejton të gjithë veprimtarinë e Shoqërisë në pikëpamjen tekniko-organizative, ka të gjitha kompetencat për të vendosur në lidhje me aktivitetin e zakonshëm dhe të përditshëm të shoqërisë. Administratori gëzon të drejtë të plotë në vendim marrje

dhe gëzon kompetenca të plota, përveç atyre që ky statut apo ligji ia njohin Asamblesë së Përgjithshme.

18.2 Të drejtat dhe detyrimet e Administratorit të shoqërisë:

- a. kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b. përfaqëson shoqërinë tregtare; kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- c. përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara Ortakut të Vetëm për miratim;
- d. krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- e. kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- f. raporton përpara Ortakëve në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- g. kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- h. administratori është i detyruar të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme përsa parashikon ky statut ose ligji.

18.3 Në rast të shkeljes së detyrës dhe standarteve profesionale, Administratori është i detyruar të dëmshpërblejë Shoqërinë, për dëmet që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë Shoqërisë çdo fitim personal që ka realizuar gjatë kryerjes së këtyre veprimeve të parregullta. Ai ka barrën e provës për të vërtetuar se kryen detyrat e tij në rregull dhe sipas standarteve.

18.4 Në veçanti, Administratori është i detyruar të dëmshpërblejë Shoqërinë, për dëmet, në qoftëse në kundërshtim me Ligjin e Shoqërive Tregtare ose pa miratim të Asamblesë së Përgjithshme kryen veprimet e mëposhtme, por pa u kufizuar në:

- a. i kthen Ortakëve kontributet;
- b. i paguan Ortakëve interesa apo dividendë;
- c. i shpërndan asetet Shoqërisë;
- d. lejon që Shoqëria të vazhdojë aktivitein e saj kur duhet ta kishte parashikuar që kjo e fundit nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet e saj;
- e. jep hua.

KREU VI

Administrimi Financiar i Shoqërisë

Neni 19

Eksperti Kontabël i Autorizuar

- 19.1 Ortakët mund të caktojnë ekspertin kontabël të autorizuar për t'i shërbyer Shoqërisë.
- 19.2 Ekspertët duhet të kryejnë funksionet audituese në përputhje me legjislacionin shqiptar.

KREU VII

Aktiviteti i Shoqërisë

Neni 20

Viti ekonomiko-financiar

- 20.1 Viti ekonomiko-financiar fillon në ditën e parë të muajit Janar dhe përfundon në ditën e 31 të muajit Dhjetor të secilit vit. Viti i parë financiar nis në datën e themelimit të Shoqërisë.

Neni 21


Mbajtja e Llogarive

- 21.1 Shoqëria do të mbajë llogaritë në lekë dhe në monedhë të huaj.

Neni 22

Llogaritja dhe Shpërndarja e Fitimit

- 22.1 Fitimi i Shoqërisë përcaktohet në bazë të bilancit të aprovuar nga Asambleja e Përgjithshme. Shpërndarja e fitimit do të caktohet nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me Statutin, marrëveshjen e Ortakëve dhe me legjislacionin e zbatueshëm.
- 22.2 Nga fitimet vjetore, do të caktohet një fond rezerve në përputhje me kushtet e legjislacionit shqiptar për fondin rezervë të detyrueshem.
- 22.3 Në bazë të Ligjit për Shoqëritë, Shoqëria mund të shpërndajë fitimin tek Ortakët vetëm nëse pas kësaj shpërndarje:
- a. Asetet e Shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e kësaj të fundit;
 - b. Shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve të ardhshëm.
- 22.4 Administratori lëshon një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kerkesat e pikës 22.3 më sipër. Ndërsa kur



gjëndja e Shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratorët nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë.

- 22.5 Administratori përgjigjet ndaj Shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese.

KREU VIII

Modifikimi i Formës Ligjore-Prishja

Neni 23

Modifikimi i Formës Ligjore

- 23.1 Forma ligjore e Shoqërisë mund të ndryshojë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme në përputhje me dispozitat respektive ne Legjislacionin Shqiptar.
- 23.2 Shoqëria e re do të përmbushë të gjitha procedurat ligjore të regjistrimit ne Shqipëri.

Neni 24

Prishja e Shoqërisë


- 24.1 Shoqëria mund të priset në rrethanat e mëposhtme:
- a. si pasojë e përfundimit të kohëzgjatjes për të cilin ishte themeluar;
 - b. me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
 - c. hapje e një procedure falimentimi;
 - d. nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për 2 vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë;
 - dh. me vendim gjykate;
 - e. për arsye të tjera të parashikuara nga Ortakët në çdo kohë.
- 24.2 Administratori regjistron prishjen e Shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Në rast se prishja e Shoqërisë bëhet me vendim gjykate, gjykata, i njofton vendimin QKB për regjistrim.

KREU IX

Neni 25

Të ndryshme

Largimi i Ortakut



- 25.1 Largimi dhe përjashtimi i një Ortaku, si dhe pasojat që kjo sjell, do të rregullohen nga Ligji i Shoqërive.

Neni 26

Të tjera

- 26.1. Çdo çështje tjetër, e cila nuk është përmendur në këtë statut, do të rregullohet nga dispozitat e Ligjit për Shoqëritë.
- 26.2. Pavlefshmëritë eventuale të dispozitave të veçanta të Statutit nuk mund të çenojnë vlefshmërinë në tërësi të tij.

ORTAKËT THEMELUES

EVISION shpk

Administratori

Martjan DEDI



Ylli STERKAJ



Indrit BANKA



Mati PEPA

